



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KURRIKULËS VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI

Nr. 486 prot.

Korçë, më 12/03/2021

RAPORT I PYETËSORIT PËR SEZONIN E PROVIMEVE TË DIMRIT


Në kuadër të mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit të provimeve të realizuara një numër i vogël i tyre online dhe pjesa tjetër në auditor, Sektori i Kurrikulave Vlerësimit Institucional dhe Alumni vëzhgoi të gjithë këtë proces, i cili u menaxhua nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë sipas rregullave të caktuara duke përfshirë edhe masat anti-Covid.

Po ashtu, u dërgua pyetësori online për studentët për të evidentuar problematikat dhe ecurinë e këtij procesi dhe marrjen e masave në rast se është e nevojshme për zgjidhjen apo shmangien e tyre në vijimësi.

Më poshtë janë analizuar të dhënat e mara nga ky pyetësor.


Pyetja 1
Pjesëmarrësit

Pyetësori u plotësua nga **56** studentë për një kohë mesatare plotësimi prej 3.5 minuta. Nga totali i pyetësorëve të plotësuar, **8** studentë ishin nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, **23** nga Fakulteti i Ekonomisë, **23** nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe **2** nga Fakulteti i Bujqësisë.



Pyetja 2 dhe 3

Për sa i përket ciklit të studimit **5** studentë ndjekin programe 2-vjecare profesionale, **44** bachelor dhe **7** master, përkatësisht **25** në vit të parë, **19** në vit të dytë, **12** në vit të tretë.



Pyetja 4

Numri i studentëve pjesëmarrës sipas programit të studimit

17 Bachelor në “Financë-Kontabilitet”	1 Program profesional 2- vjeçar “Shërbim Social”
16 Master Profesional në “Mësues i Gjuhës Angleze”	1 Master Profesional në “Mësues në Matematikë-Informatikë dhe Fizikë”
8 Bachelor në “Gjuhë-Angleze”	1 Master Profesional në “Mësues për Arsimin Fillor”
6 Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”	1 Master Profesional në “Mësues në Biologji-Kimi ”
3 Bachelor në “Menaxhim”	1 Program profesional 2- vjeçar “Menaxhim Veterinar”
3 Bachelor në “Gjuhë-Letërsi”	1 Master Profesional në “Mësues për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi ”
2 Bachelor në “Biologji-Kimi”	1 Program profesional 2- vjeçar “Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë dhe Arkiv”
2 Master i Shkencave në “Kulturë Media Editim”	1 Program profesional 2- vjeçar “Asistent Menaxher”
1 Bachelor në “Infermier i Përgjithshëm”	
1 Bachelor në “Teknologji Informacioni”	
1 Bachelor në “Matematikë-Informatikë”	
1 Bachelor në “Informatikë Biznesi”	
1 Bachelor në “Ekonomiks”	
1 Bachelor në “Histori-Gjeografi”	
1 Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”	

Pyetja 5

95% e studentëve pjesëmarrës janë përgjigjur që janë njoftuar për mënyrën e zhvillimit të provimit për secilën lëndë. (Online ose në Auditor)

Pyetja 6

Mënyra e njoftimit për formën dhe datën e provimit

Përsa i përket mënyrës së njoftim përqindja më e lartë e përgjigjeve ka qenë se janë venë në dijeni nga pedagogu i lëndës në masën 54%.

21.5% e tyre janë shprehur se janë informuar Nëpërmjet njoftimeve në WEBSITE

14.5% e studentëve pjesëmarrës kanë pohuar se janë njoftuar Nëpërmjet sistemit elektronik ESSE3

8.5% e kanë marrë informacionin Nga përgjegjësi i departamentit

dhe 1.5% në një mënyrë tjetër të ndryshme nga këto më sipër

Pyetja 7

Problematikat gjatë sezonit të provimeve

46% kanë pohuar se nuk kanë hasur **asnjë problematikë**. Kjo është një përgjigje e kënaqshme sepse tregon se rreth gjysma e tyre ndajnë mendim pozitiv përse i përket zhvillimit të provimeve pa problematika

25% janë shprehur se **koha e zhvillimit të provimit ishte e pamjaftueshme** dhe teza e provimit ishte e mbingarkuar duke marrë parasysh zhvillimin e leksioneve në mënyrë të reduktuar gjatë mësimit online


18% kanë cilësuar si problematikë **vështirësinë në kuptimin e temave të mësimit për shkak të mësimit online dhe njohuritë që kanë marrë nuk ishin të mjaftueshme** për të realizuar zhvillimin e tyre në tezat e provimeve

11% kanë përmendur problematika të ndryshme të përmendura shumë pak herë si më poshtë:

-Datat e provimeve ishin shumë afër njëra me tjetrën

-Sezoni duhet të ishte më i zgjatur në këtë periudhë problematike në të cilën u zhvillua

-Ngarkesa ka shkaktuar stres



Pyetja 8

Pyetjes nëse kanë pasur probleme gjatë zhvillimit të provimeve “online” studentët pjesëmarrës i janë përgjigjur me “JO” në masëm 70%, krahas 23% që kanë pohuar se kanë pasur problematika dhe 7% pa përgjigje.

Këto të dhëna tregojnë se zhvillimi i provimeve online në pjesën më të madhe të tyre ka shkuar siç duhet.

Pyetja 9

Problematikat e hasura gjatë provimeve online


Nga 23% e studentëve që kanë pohuar se kanë pasur problematika gjatë provimeve online, **11%** e tyre janë shprehur se **nuk kanë zhvilluar provime online** por në auditor, përgjigje e cila logjikisht rrit përqindjen e mësipërme të mos hasjes së problematikave.

9% kanë cilësuar si problematike kohëzgjatjen e provimit ndërsa 3% shkëputjen dhe probleme me internetin

Pyetja 10

Kohëzgjatja e provimeve ishte sipas përcaktimeve të udhëzimit për provimet e sezonit të dimrit apo jo?

Kësaj pyetjeje studentët pjesëmarrës i janë përgjigjur me “PO” në masën 82% duke pohuar kështu kohëzgjatjen sipas udhëzimeve, kundrejt 18% që janë përgjigjur me “JO”.



Pyetja 11

Masat ANTI-COVID

75% e pjesëmarrësve janë shprehur se janë respektuar masat anti-Covid, ndërsa 25% kanë pohuar se kanë vërejtur mosrespektim të tyre.

Pyetja 12

Për sa i përket **vlerësimit** të procesit të zhvillimit të provimeve nga 1 deri në 5, ku 1 tregon pikën më të dobët dhe 5 pikën më të fortë, vlerësimi total ka qenë në nivel mesatar prej 2.91.

Shprehur në përqindje:


23.2% kanë dhënë vlerësimin 5

10.7% kanë dhënë vlerësimin 4

25% kanë dhënë vlerësimin 3

16% kanë dhënë vlerësimin 2

25% kanë dhënë vlerësimin 1



Pyetja 13

Mendime dhe sugjerime rreth zhvillimit të sezonit të provimeve

75% e pjesëmarrësve e kanë lënë **pa përgjigje** këtë pyetje ose nuk kanë asnjë mendim apo sugjerim për të shtuar

10% janë shprehur se **provimet duhet të ishin zhvilluar të gjitha online** pasi auditorët u janë dukur të rrezikshme ndërsa **3%** e tyre janë shprehur se **provimet duhet të zhvilloheshin të gjitha në auditor**.

Të përmendura vetëm një herë që gjithsej përbëjnë **12%** të përgjigjeve janë mendimet më poshtë:

- Tezat kanë qenë të mbingarkuara
- Koha e dorëzimit të provimit ka qenë shumë e shkurtër ose përdorimi i programeve të caktuara e ka vështirësuar procesin
- Pakënaqësi nga mënyra e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar
- Procesi ka pasur vështirësi sidomos për studentët e viteve të para
- Për shkak të mësimit online kanë mbetur boshllëqe nëpër lëndë të ndryshme
- Provimet të bëhen të alternuara
- Për provimet që zhvillohen në auditor të zgjatet koha e zhvillimit të provimit

Këto përqindje të vogla lenë të kuptohet se mendimet e shprehura janë deri diku subjektive.

PËRFUNDIME

1. Qëllimi i zhvillimit të këtij pyetësori i trajtuar që në hyrje të tij synoi nxjerrjen e problematikave që studentët mund të kenë hasur gjatë procesit të sezonit të provimeve dhe marrjen e masave për zgjidhjen e tyre.
2. Numri i vogël i pjesëmarrësve tregon se ky pyetësor është plotësuar nga ata studentë të cilët kanë pasur diçka për të shprehur ose kanë pasur dëshirë të japin mendimin e tyre, kjo është me rëndësi pasi na le të kuptojmë se sezoni i provimeve është kaluar në tërësinë e tij pa problematika madhore.
3. Këtë e tregon edhe përqindja prej 46% e pjesëmarrësve të shprehur që nuk kanë hasur asnjë problematikë gjatë të gjithë sezonit, 70% që nuk kanë hasur probleme gjatë zhvillimit të provimeve online, 82% që janë shprehur se kohëzgjatja ka qenë sipas udhëzimeve, 75% që janë shprehur se janë respektuar masat anti-Covid dhe po ashtu 75% që nuk kanë pasur asnjë mendim apo sugjerim shtesë.
4. Por pavarësisht përqindjeve të vogla ka pasur disa problematika të përmendura si: koha e zhvillimit të provimit e pamjaftueshme dhe teza e provimit e mbingarkuar, duke marrë parasysh zhvillimin e leksioneve në mënyrë të reduktuar gjatë mësimit online.
5. Një problematikë që mund të merret në konsideratë është vështirësia në kuptimin e temave të mësimit për shkak të mësimit të zhvilluar online dhe njohuritë që janë marrë nuk ishin të mjaftueshme për të realizuar zhvillimin e tyre në tezat e provimeve.

SUGJERIME

Pavarësisht sa më sipër, ka ende vend për përmirësim në mënyrë që procesi i sezonit të provimeve të kalohej pa ju shkakuar studentëve problematika të veçanta.

Disa prej sugjerimeve mund të jenë:

1. *Rishikimi i tezave të provimeve në mënyrë që zhvillimi i tyre të përkojë me kohëzgjatjen e provimit*

2. *Rishikimi i tezave të provimeve duke shmangur mbingarkesën duke marrë parasysh zhvillimin e reduktuar të temave të leksioneve gjatë mësimit online*
3. *Të përmirësohen mënyrat e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar duke u mbështetur në procesin e zhvillimit online të leksioneve, seminareve apo dorëzimit të detyrave të kursit dhe zhvillimit të provimeve*
4. *Të përshtatet metodologjia duke përdorur strategji të ndryshme të mësimit online, për të shmangur vështirësitë në kuptimin e temave të mësimit dhe për të mbajtur studentët e interesuar dhe aktivë.*

Spektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni
Evis Kapurani

